

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DOLLINA JE PRAVNOŠNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC
NË EMËR TË POPULLIT

08.02.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi dhe me sekretaren juridike Vildane Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nenpar 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.358-5/16 të dt. 27.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani dhe të pandehurve [REDAKTUAR] me av. mbrojtësë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i me av. [REDAKTUAR] me datë 14 Shtator 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 20 Shtator 2016 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

TE AKUZUARIT:

[REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Rr. [REDAKTUAR] në Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

[REDAKTUAR] lindur me dt. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Rr. [REDAKTUAR] në Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

JANË FAJTOR

Sepse me datë 29.03.2016, rreth orës 09:40, në Ferizaj, përkatsisht në rrugën “Dëshmoret e Kombit”, në vendparkingun e veturave kanë sulmuar të dëmtuarin [REDAKTUAR] dhe gruan e tij e tij [REDAKTUAR] në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ka qenë duke tentuar për të hyrë në parking i pandehuri [REDAKTUAR] kishte ndaluar veturen duke i zënë parkingun dhe

pas fjalosjes i njejti e ka goditur ne fytyrë me grushta e pastaj edhe i pandehuri [REDACTED] ka ndërhyrë duke e goditur mbrapa ne qafë dhe shpinë me duar, ku si pasoj e këtyre goditjeve i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje dhe gërvishje e indeve të buta në regjionin e kokës, hundës, qafes dhe shpines, gjak mbledhje nënlëkurore në regjionin për rreth syrit të majtë, të te pëshkruara ne ekspertizen mjeko-ligjore të dt. 18.04.2016.

me të cilën kryenin veprën penale ne bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nen par.1.4 lidhu me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit te sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, i

G J Y K O N D Ë N I M M E K U S H T E

Të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] i gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 /tetë/ Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit në afatin prej 1 /një/ Viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në dënimin e shqiptuar si më lart i llogaritet edhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga data 29.03.2016 deri me daten 28.04.2016.

I dëmtuari [REDACTED] nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Obligohen te akuzuarit në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30/tridhjetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale shumen prej 170 /njëqindeshtatëdhjetë/ €, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - me aktauzën të evidentuar PP.nr.358-5/16 të dt. 27.04.2016, ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për veprën penale ne bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nen par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me qëndrim se mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehurit të shpallet fajtorë dhe të ju shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 14 Shtator 2016, në të cilën shqyrtim gjyqësor te akuzuarit [REDAKTUAR] pas konsultimeve me avokatët mbrojtës të tij ka deklaruar se: *ndjehem fajtor për veprën për të cilën na ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin të thellë për veprën penale të kryer, si dhe i premtojnë gjykates se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre, jemi te gatshem ti kompenzojn dëmin te dëmtuarit.*

Av. mbrojtës i te pandehurit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR] ne lidhje me pranimin e fajsisë ka deklaruar: i pandehuri eshte keshilluar me mua si mbrojtës, eshte i vetdishem per pasojat qe rrjedhin nga pranimi i fajsisë, me vullnetin e tij dhe ne shenje pendimi e ka pranuar fajsinë.

I akuzuari [REDAKTUAR] pas konsultimeve me avokatët mbrojtës të tij ka deklaruar se: ndjehem fajtor për veprën për të cilën na ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin të thellë për veprën penale të kryer, si dhe i premtojnë gjykates se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre, jemi te gatshem ti kompenzojn dëmin te dëmtuarit.

Av. mbrojtës i te pandehurit [REDAKTUAR] i, av. [REDAKTUAR] ne lidhje me pranimin e fajsisë ka deklaruar: pas keshillimit te mjaftueshem me klientin tim dhe duke pas

parasysh pasojat e pranimit te fajsisë klienti im e ka pranuar ne tersi aktakuzen e prokurorit te shtetit lidhur me kete veper penale.

Prokurori i Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë për të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- te akuzuarit kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht: mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore si dhe ne shqyrtimin gjyqësor: ekspertiza mjeko-ligjore nr. Ref.: Fe-037 e dt. 18.04.2016, deklarata e te dëmtuarit [REDACTED] dt. 30.03.2016, deklarata e dëshmitares [REDACTED] dt. 27.04.2016, raporti i oficerit nr. rasti 2016-CF-0605, pjeserist deklarata e te pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] dt. 29.03.2016 si dhe Akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të ekzaminimit klinik të dt. 07.07.2016, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore si dhe kjo e fundit te bere gjatë rrjedhes se procedures penale;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se te akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin*

gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i letë trupor në bash kryerje nga neni 188 par. 1 nen par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në diapozitivin e këtij aktgjykimi të akuzuarve me dashje direkt, në atë mënyrë që i dëmtuari ka qenë duke tentuar për të hyrë në parking i pandehuri [REDAKTUAR] kishte ndaluar veturen duke i zënë parkingun dhe pas fjalosjes i njejtë e ka goditur në fytyrë me grushta e pastaj edhe i pandehuri [REDAKTUAR] ka ndërhyrë duke e goditur mbrapa në qafë dhe shpinë me duar, ku si pasojë e këtyre goditjeve i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje dhe gërvishje e indeve të buta në regjionin e kokës, hyndes, qafes dhe shpines, gjak mbledhje nënllëkurore në regjionin për rreth syrit të majtë, duke i shkaktuar atij: ndrydhje dhe gërvishje në koke me pasojë të përkohshme për shëndetin.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 188, arrihet në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pasjelle përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të të dëmtuarit, duke i sjelle atij paaftësi të përkohshme. Në rastin konkret veprimet e dhunës duhet të sjellin si pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial e ekonomik, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale. Me integritet fizik do të kuptohet e drejta dhe mundësia që ka një person për të zotëruar dhe kontrolluar vetë trupin e tij dhe për tu ndier i sigurtë nga çdo formë e dhunës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, rrethanë lehtësuese pendimin real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, gadishmerin për kompensim dëmi, e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se të akuzuarit deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-së, obligohen të pandehurit që mënyre solidare në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30/tridhjetë/€, dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko-ligjore) shumen prej 20 /njëzet /€, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurve, te cilët obligohen që të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.337/16 me datë 20.09.2016.**

**Sekretare Juridike,
Vildane Azemi**

**Gjyqtari Individual,
Ilir BYTYQI**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.